



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 13.01.2017

Vendim
Nr. 04, datë 13.01.2017

**PËR MIRATIMIN E GRUPEVE MËSIMORE ME KARAKTER KËRKIMOR-
SHKENCOR TË DEPARTAMENTEVE TË FAKULTETIT TË EKONOMISË**

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të rekomandimeve të MAS për organigramën e fakulteteve dhe mungesën e grupeve mësimore e kërkimore (Raporti i Inspektimit nr 5265, prot, datë 01. 08. 2014, faqe 7), dhe në zbatim të Vendimit Nr. 32 të Senatit Akademik, datë 06. 09. 2016, "Për fillimin e procesit të riorganizimit akademik dhe administrativ të institucionit dhe hartimin e strukturës së përgjithshme të tij", Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.01.2016

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departmentit të Biznesit nr. 3 prot, datë 12.01.2017 për ngritjen e grupeve të përkohshme me karakter mësimor si vijon:
 - a) Grupi me karakter mësimor i Marketing-Turizmit
 - b) Grupi me karakter mësimor i Biznesit.
2. Të miratojë propozimin e Departmentit të Financës nr. 3/1 prot, datë 12.01.2017 për ngritjen e grupeve të përkohshme me karakter mësimor si vijon:
 - a) Grupi me karakter mësimor i Financës
 - b) Grupi me karakter mësimor i Kontabilitetit.
3. Të mos e miratojë propozimin e Departmentit të Ekonomiksit nr. 3/2 prot, datë 12.01.2017 për ngritjen e grupeve të përkohshme me karakter mësimor dhe t'i sugjerojë departamentit rishikimin e emërimit të grupeve.
4. Këto njësi bazë dhe emërtimi i tyre të reflektohen në strukturën dhe organikën e re të Fakultetit të Ekonomisë dhe Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Rektori, Kancelari, zv/Rektori, Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, përgjegjësit e njësive bazë të Fakultetit të Ekonomisë, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
6. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.